VENDIM
Nr.1010, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E SHTESËS NR.3 TË KONTRATËS, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE "LOCKHEED MARTIN GLOBAL, INC" PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.665, DATË 18.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 "Për aviacionin civil shqiptar" dhe të neneve 128 e 151 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës nr.3 të kontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), dhe "Lockheed Martin Global, Inc", për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar, të miratuar me vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e projektkontratës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe "Lockheed Martin Global, Inc", "Për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar", të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fondet për financimin e shtesës së kontratës të përballohen nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA).
3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha